



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 22.04.2025
Numër protokolli: 2729/2025

A.nr.430/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.430/2025, të datës 07.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.K, kundër organit të punësimit/ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.430/2025 të datës 07.03.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.K.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil A.K. (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 07.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me numër protokolli 572 të datës 25.02.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me shpalljen e kandidatit fitues për pozitën e punës “*Inspektor i Pylltarisë*”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 29.08.2024, ka shpallur konkursin me numër reference RN00014954, për grupin e Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, për pozitën e punës Inspektor i Pylltarisë, me klasë të pozitës Profesional 1, dy (2) vende pune, i hapur për aplikim nga data 30.08.2024 deri më datën 28.09.2024.

Rrjedhimisht nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë (44) kandidatë, ndër ta edhe ankuesi, ndërsa, vetëm 23 kandidatët janë përfshirë në listën e kandidateve që kanë plotësuar kriteret e konkursit, gjegjësisht, sipas Njoftimit me numër protokolli 3905, të datës 08.10.2024, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit sipas pikës 3 të konkursit, pasi që i njëjti nuk ka përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 08.11.2024, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 4284, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë të suksesshëm për procedurën përkatëse të rekrutimit janë shpallur, I.K, me 90.2 pikë dhe A.T.Sh. me 87.4 pikë.

Pas publikimit të Njoftimit me numër protokolli 4284, të datës 08.11.2024, ankuesi brenda afatit ligjor kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e Njoftimit të datës 08.10.2024 për refuzimin e aplikacionit si dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidateve të suksesshëm, mbi pretendimin ankimor se ky proces rekrutimi është përcjellë me shkelje të ligjit material, dhe si për rrjedhojë ka kërkuar që Këshilli të aprovoj ankesën dhe të shfuqizoj vendimin e kontestuar.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankesë është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1863/2024, të datës 05.02.2025, ku si për pasojë është ndryshuar Lista e verifikimit paraprak me numër protokolli 3958, e datës 10.10.2024, lista e renditjes përfundimtare e kandidateve e datës 08.11.2024, si dhe njoftimi me numër protokolli 4284, i datës 08.11.2024, lidhur me shpalljen e kandidatëve të suksesshëm në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00014954, pozita Inspektor i Pylltarisë, ashtu që, kandidatet A.T-SH, dhe Z.K, largohen nga lista e verifikimit paraprak dhe lista e renditjes përfundimtare, ndërsa kandidatja A.T-SH, largohet edhe nga njoftimi për shpalljen e kandidateve të suksesshëm, kurse, pjesa tjetër e njoftimit me numër protokolli me numër protokolli 3958, e datës 10.10.2024, lista e

renditjes përfundimtare e kandidateve e datës 08.11.2024, si dhe njoftimi më numër protokolli 4284, i datës 08.11.2024, kishin mbetur të pandryshuara, dhe ishte lënë fuqi Njoftimi me numër protokolli 3905, i datës 08.10.2024, i Njësisë së Burimeve Njerëzore, në Ministrinë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.1863/2024, të datës 05.02.2025, është shqyrtuar meritorisht Konkursi me numër reference RN00014954, për pozitën *Inspektor i Pylltarisë* në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***, ngase akti i kontestuar me ankesën e datës 07.03.2025, nga ankuesja është nxjerrë vetëm në zbatim të Vendimit të sipër theksuar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe si i tillë objekti është bërë i pamundur.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.430/2025, të datës 07.03.2025 siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.430/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.K;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.